

PERMBAJTJA

HYRJA.....	26
Vështrim i përgjithshëm.....	26
Furnizimi me energji.....	27
Aktivizimi fillestar.....	28
Tastiera.....	29
Ekрани.....	30
Menuja kryesore.....	30
FJALORI.....	31
FJALORI I PËRDORUESIT.....	33
GRAMATIKA.....	34
LIBRI I FRAZAVE.....	34
FOLJET E PARREGULLTA.....	35
IDIOMA TË NJOHURA.....	35
TELEFONA.....	36
ORARI.....	36
KALKULATOR.....	38
SHKËMBIMI METRIK.....	38
SHKËMBIMI I MONEDHËS.....	38
LOJA ME FJALË HANGMAN.....	39
KOHA NË BOTË.....	39
KOHA NË VEND.....	40
LIDHJE ME KOMPJUTER.....	40
VENDOSJA.....	41
Paraqitja gjuhësore.....	42
Bllokimi i zhargonit.....	42
Kërkim i përparuar.....	42
Sinjali i butonit.....	42
Ora.....	42
Vendosja e datës.....	43
Vendosja e kohës.....	43
Programi i alarmit.....	43
Alarm i përditshëm.....	43
Kontrolli i kujtesës.....	43
Fshirje e të dhënave.....	43
Vendosja e fjalëkalimit.....	44
Mënyra e mbrojtjes.....	44
Nivelimi i kontrastit.....	45
Variantet e të folurit.....	45
Vë kohën e fikjes.....	45

HYRJA


Përgëzime për blerjen e Partner® EAI400T! Ky produkt është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të gjuhëtarëve, inxhinierëve dhe programuesve të Ectaco dhe përfaqëson gjeneratën e fundit të pajisjeve arsimore të integruara me funksionimin më të mirë që janë të disponueshme.

Partner® EAI400T paraqet:

- ❖ *Fjalorin kryesor (fjalor me dy seksione anglisht-shqip) prej përafërsisht 450,000 fjalë, përfshirë terma mjekësorë, teknikë, ligjorë dhe biznesi, si dhe zhargon, idioma dhe shprehje të përgjithshme*
- ❖ *Vëllimin e gramatikës elektronike të anglishtes*
- ❖ *Një përzgjedhje të idiomave amerikane më të njohura*
- ❖ *Foljet e parregullta të anglishtes*
- ❖ *Vëllimin prej 12 subjektsh të frazave të zakonshme të anglishtes*
- ❖ *Riprodhimin e përparuar të të folurit të anglishtes*
- ❖ *Funksionin e regjistrimit për fjalë të reja*
- ❖ *Përkthimin e menjëhershëm në të kundërt*
- ❖ *Sistemin e kontrollit të drejtshkrimit dygjuhësor me cilësi të lartë Vector Ultima™*
- ❖ *Planifikuesin personal anglisht/shqip 128Kb për orarët dhe numrat telefonikë, i pajisur me funksionin e kërkimit*
- ❖ *Kohën në vend dhe në botë*
- ❖ *Shkëmbimin me shpejtësi të lartë të të dhënave me një kompjuter*
- ❖ *Paraqitjen dygjuhësore*
- ❖ *Sistemin e mbrojtjes së të dhënave*
- ❖ *Funksionin e bllokimit të zhargonit*
- ❖ *Fole për energji të jashtme për funksionimin me AC*
- ✓ *Meqëse nga prodhuesi bëhen përpjekje të vazhdueshme për të siguruar cilësinë dhe funksionimin më të mirë të produkteve Partner®, disa karakteristika të pajisjes që ju keni blerë mund të ndryshojnë pak nga përshkrimi i tyre në këtë manual.*

Vështrim i përgjithshëm

Vështrimi i përgjithshëm dhe tiparet e jashtme të EAI400T janë paraqitur më poshtë.



Furnizimi me energji

EAI400T funksionon me dy bateri AAA (LR03).

Kur bateritë shkarkohen, do të shfaqet një mesazh paralajmërues.

Me qëllim që të parandalohet shkarkimi i tepërt i baterive dhe të mos rezultojë në një humbje të të dhënave në RAM, funksioni *Shqiptimi* dhe mënyrat e komunikimit do të çaktivizohen nëse bateritë janë në shkarkim.

Për të rivendosur funksionimin e plotë të pajisjes dhe për të shmangur rrezikun e humbjes së të dhënave të përdoruesit, zëvendësoni të dyja bateritë sa më shpejt që të jetë e mundur. Mos i përziejni bateritë e vjetra dhe të reja.

Si t'i zëvendësojmë bateritë

- Sigurohuni që pajisja të jetë e fikur. Shtypni Ndizet/Fiket për t'a fikur pajisjen.
- ✓ Asnjëherë mos u përpiqni t'i hiqni bateritë nga pajisja kur ajo është e ndezur. Kjo mund të dëmtojë seriozisht pajisjen. Nëse jeni duke përjetuar vështirësi në fikjen e pajisjes, shtypni butonin e riaktivizimit në anën e djathtë të tastierës (mbi butonin O) dhe riaktivizoni sistemin.
- Hiqni mbulesën e ndarjes së baterive duke e rrëshqitur atë larg nga pajisja.
- Hiqni bateritë e përdorura dhe zëvendësojini ato me të reja.
- ✓ Kur zëvendësoni bateritë, keni 2 minuta kohë për të vendosur të rejat në pajisje pa rrezikun e humbjes së ndonjë të dhëne të vendosur në RAM. **Mos e kapërceni kufirin prej 2 minutash!** As prodhuesi dhe as shitësi nuk mund të konsiderohen përgjegjës për humbjen e të dhënave të përdoruesit.
- Sigurohuni që t'i vendosni bateritë sipas shenjave të polaritetit (+ -) brenda ndarjes.
- Vendoseni mbulesën e ndarjes së baterive duke e rrëshqitur atë nga pajisja. Sigurohuni që mbulesa të qëndrojë në vend siç duhet.
- ✓ EAI400T është i pajisur me një fole për furnizimin me energji nga jashtë.
- ✓ **Përdorimi i një furnizimi të papërshtatshëm me energji nga jashtë mund të anultojë garancinë.** Adapteri AC/DC duhet të sigurojë 6V dhe minimumi 300mA DC.
- ✓ Komunikimi me një kompjuter konsumon një sasi të konsiderueshme energjie. Gjithnjë përpiquni të përdorni një furnizim me energji nga jashtë gjatë këtyre veprimtarive.

Aktivizimi fillestar

Aktivizimi fillestar ndodh

- kur EAI400T ndizet për herë të parë;
- kur i hiqni bateritë (p.sh. gjatë zëvendësimit);
- pasi sistemi është riaktivizuar me butonin e riaktivizimit.
- ✓ Butoni i riaktivizimit gjendet në anën e djathtë të tastierës (mbi butonin O). Ai mund të përdoret me ndonjë send të hollë si një kapse dokumentash. Mos përdorni asnjëherë gjilpërë ose karficë për këtë qëllim, pasi mund të dëmtojnë pajisjen.
- Nëse shihni *T'a hap sistemin?* (y/n), shtypni butonin N për të shmangur aktivizimin fillestar dhe vendosjen e të dhënave tuaja.

Mesazhi *Sistemi është hapur!* tregon se aktivizimi fillestar i sistemit ka përfunduar dhe se janë rivendosur regjistrimet automatike të përcaktuara nga fabrika.

- Pastaj do të shihni mesazhin *T'i fshij të gjitha të dhënat?* Shtypni butonin N për të ruajtur të dhënat tuaja.

Tastiera

Tastiera standarte amerikane QWERTY është bashkërenduar me renditjen standarte shqiptare.

Për të futur shenja të tjera në shqip (të shënuara me të verdhë tek butonat), shtypni ALT+ butonin e dëshiruar.⁵

Për të futur shenja të tilla të mëdha, shtypni SHIFT+ ALT+ butonin e dëshiruar.

- ✓ Ndryshe nga tastierat e kompjuterëve, nuk është e nevojshme të mbani të shtypur një buton (të tillë si SHIFT) ndërsa shtypni një tjetër. Mjafton që t'a shtypni atë vetëm njëherë dhe t'a lëshoni.

Tërësia e shkronjave kombëtare të disponueshme varet se cila formë e informacionit gjuhësor është zgjedhur. Format gjuhësore mund të ndryshohen duke shtypur butonin ⇔. ENG ose ALB shfaqet përkatësisht në këndin lart djathtas.

Butonat e funksionit të lidhjes së drejtpërdrejtë

ON/OFF (Ndizet/Fiket)	Ndez ose fik pajisjen
RESET (Riaktivizim)	Ri-aktivizon sistemin
SPELLER (Drejtshkrimi) (SHIFT+ ▼ or ▲)	Aktivizon kontrolluesin e drejtshkrimit

Butona të tjerë të lidhjes së drejtpërdrejtë aktivizojnë seksionet korresponduese të shenjave mbi butona (SHIFT+ butonat të lidhjes së drejtpërdrejtë).

Butonat e kontrollit dhe të drejtimit

←, →	Lëviz shigjetën / nënvizon / ndryshon menunë kryesore
↓, ↑	Nënvizon / kalon nëpër rreshta / ndryshon menunë kryesore / ndryshon vlerat. Përdorni ↑ për të kaluar ndërmjet formës Vendos dhe Shkruaj sipër.
▼, ▲	Kalon nëpër faqe
ENTER	Ekzekutim
SPACE	Fut spacio
ESC	Mbyll dritaren aktive / anulim / kthim në faqen e mëparshme
ALT	Fut simbolet nga butonat me dy shkronja ⁶




⁵ Butoni 1+ butonin 2 këtu dhe më tej nënkuptojnë kombinimin e butonave që do të përdoren - së pari shtypni dhe lëshoni butonin 1, pastaj shtypni dhe lëshoni butonin 2.

SHIFT	Shtyp me gërmë të madhe
←BS	Fshin shkronjën në të majtë të shigjetës
↔	Ndryshon drejtimin e gjuhës ose të përkthimit
SHIFT+↑	Aktivizon simbole të tjerë ⁷
SHIFT+↓	Aktivizon regjistrimin për t'a redaktuar
SHIFT+BS	Fshin regjistrimin
SAY	Shqipton fjalën ose frazën kryesore
SHIFT+SAY	Shqipton një përkthim
A, P	Përcakton AM ose PM (kur vendoset formati 12 orësh)

Ekрани

Partner® EAI400T paraqet një ekran me qartësi të madhe (160x64 piksa).

Vija treguese është në krye të ekranit dhe paraqet shenjat e mëposhtme:

EDIT	Regjistrimi i tanishëm i aktivizuar në formën redaktuese
SHIFT	Butoni SHIFT është i shtypur
INS	Forma Vendos është zgjedhur
	Bateritë në shkarkim
	Pajisja është e mbyllur
	Alarmi është vendosur
▼▲	Kalon vertikalisht ose lejon përbërjen në disa faqe (më shumë tekst është i disponueshëm)
◀▶	Lejon kalimin horizontal

Menuja kryesore





MENUJA KRYESORE EAI400T përbëhet nga 16 shenja funksionale, të cilat organizojnë në mënyrë vizuale mundësinë e përdorimit të seksioneve të fjalorit.

- Për të shfaqur MENUJA KRYESORE, ndizni pajisjen ose mbyllni seksionin e tanishëm.
- Lëvizni ndërmjet shenjave duke përdorur ↓, ↑ ose ←, →.
- Për të hapur një seksion, shenja e të cilit është nënvizuar, shtypni ENTER.

Shenjat e paraqitura tek MENUJA KRYESORE përfaqësojnë seksionet e mëposhtëm:

⁶ Shtypni ALT+ butonin korrespondues për të futur shkronjat me të vogël në shqip, të shënuara me të verdhë tek butonat. Për të patur shkronjat më të madhe të tyre, shtypni SHIFT+ALT+ butonin korrespondues.

⁷ Shtypni ▼, ▲ për të kaluar ndërmjet tre rreshtave të simboleve. Shtypni butonin e numrit korrespondues për të futur simbolin e dëshiruar.

	Fjalori		Kalkulator
	Fjalori i përdoruesit		Shkëmbimi metrik
	Gramatika		Shkëmbimi i monedhës
	Libri i frazave		Loja me fjalë Hangman
	Foljet e parregullta		Koha në botë
	Idioma të njohura		Koha në vend
	Telefona		Lidhje me kompjuter
	Orari		Vendosja

FJALORI

Seksioni *Fjalori* përfshin fjalorin me dy pjesë anglisht-shqip që përmbajnë mbi 225,000 fjalë secila.

- Hapni seksionin *Fjalori*.
- ✓ Pas aktivizimit të sistemit, fjalori anglisht-shqip zgjidhet automatikisht.

Shikimi i regjistrimeve

- Për të parë përkthimin e një fjale, shkruajeni atë nëpërmjet tastierës.

Shqip ⇔ Anglisht
fabriki

FABRIKIM

- Ndërsa jeni duke shtypur, fjala e parë që është më e ngjashme nga drejtshkrimi me pjesën që keni shkruar deri tani do të shfaqet nën vijën e informacionit. Kur të shfaqet fjala e dëshiruar, shtypni ENTER për të parë përkthimin(et) e saj.
- ✓ Ju mund të përshpejtoni punën e *Fjalorit* tuaj duke e fikur formën *Kërkim i përparuar* (shihni Faqen 42).

FABRIKIM
[N]
FABRICATION,
PRODUCTION,
MANUFACTURE, MILLING

Përdorni:

- ↓, ↑ për të kaluar mes përkthimeve
- ▲, ▼ për të kapërcyer mes regjistrimeve të afërta
- Shtypni ESC ose ndonjë buton të shkronjave për t'u kthyer tek vija e informacionit dhe për të përkthyer një fjalë tjetër në të njëjtin fjalor. Ju mund të ndryshoni drejtimin e përkthimit duke shtypur ⇌.

Pjesët e ligjëratës dhe treguesit e gjinisë

Përkthimet e një fjale të parë janë të renditura në rendin alfabetik sipas pjesëve të ligjëratës.

A – mbiemër	ID – idiomë	PHR – frazë
ABBR – shkurtime	INTRJ – pasthirrmë	PREF – parashtesë
ADV – ndajfolje	N – emër	PREP – parafjalë
ART – nyje	NPR – emër i përveçëm	PRON – përemër
AUX – ndihmëse	NUM – numëror	SUFF – prapashtesë
CONJ – lidhës	PART- pjesëz	V – folje

Përkthim i menjëhershëm në të kundërt

Për lehtësine tuaj, EAI400T siguron një *Përkthim të menjëhershëm në të kundërt* për të gjitha fjalët dhe shprehjet në *Fjalor*.

- Shtypni ←, → për të zgjedhur një fjalë ose një shprehje për përkthim në të kundërt.

TRANSLATION
[N]
PËRKTHIM , TRANSFERIM, TRANSMETIM, LËVIZJE DIREKT

- Shtypni ENTER për të marrë përkthimin e menjëhershëm në të kundërt të saj.

Ju mund të kryeni deri në katër përkthime në të kundërt njëri pas tjetrit (pa mbyllur dritaret). Mesazhi *Përkthimi i fundit* shfaqet nëse arrihet ky kufi.

Përdorni:

- ESC për të mbyllur dritaret e *Përkthimit në të kundërt*⁸
- SHIFT+DICT ose ndonjë buton të shkronjave për t'u kthyer në vijën e informacionit

Kontrolluesi i drejtshkrimit Vector Ultima™

Kur nuk jeni të sigurtë për drejtshkrimin e një fjale, do t'ju ndihmojë kontrolluesi i drejtshkrimit shumë-gjuhësor Vector Ultima™.

⁸ Dritaret do të mbyllen në rradhën e kundërt.

- Shkruajeni fjalën siç e dëgjoni. Për shembull, “foll” për “fall”.
- Shtypni SHIFT+SPELLER në tastierë (SHIFT dhe njërin prej butonave ▲, ▼). Në ekran shfaqet një listë e *Varianteve* të sugjeruar.
- Zgjidhni fjalën e dëshiruar dhe shtypni ENTER.
- ✓ Nëse kontrolluesi i drejtshkrimit nuk është në gjendje të sugjerojë fjalë të tjera, shfaqet mesazhi *Asnjë variant*.

Shqiptimi i fjalëve dhe fjalive

Teknologjia Teks-në-gjuhë siguron shqiptimin e çdo fjale dhe fraze anglisht.

- Paraqitja e një regjistrimi.

Përdorni:

- SAY për të dëgjuar shqiptimin e fjalës së parë anglisht
- SHIFT+SAY për të dëgjuar shqiptimin e të gjithë përkthimeve të shfaqura në anglisht
- Ju gjithashtu mund të dëgjoni çdo fjalë ose frazë të zgjedhur në anglisht të renditur në regjistrim. Thjesht zgjidhni duke përdorur ←, → dhe shtypni Shqiptimi.
- ✓ Pajisja është në gjendje të krijojë shqiptimin e çdo teksti në anglisht, jo vetëm regjistrimeve të fjalorit. Thjesht shtypni një fjalë ose një frazë në vijën e informacionit të *Fjalorit anglisht-shqip* dhe shtypni Shqiptimi për të dëgjuar shqiptimin e saj.


FJALORI I PËRDORUESIT

EAI400T ju lejon të krijonin fjalorin tuaj.

- Hapni seksionin *Fjalori i përdoruesit* dhe zgjidhni një prej fjalorëve të përdoruesit.

Regjistrimi

Regjistrimi përbëhet nga një fjalë ose shprehje, përkthimi i saj dhe pjesa e saj e ligjeratës. Ai gjithashtu përmban informacion mbi numrin tregues të këtij regjistrimi dhe numrin e përgjithshëm të regjistrimeve.



Krijimi i një regjistrimi

- Kur keni hapur një listë regjistrimi, shtypni ENTER për të krijuar një mostër të re regjistrimi.
- ✓ Nëse fjalori është bosh, një mostër e re regjistrimi do të hapet automatikisht.
- Shtypni një fjalë ose një shprehje. Shtypni ENTER.

Fjala shqipe:	SHQ
ingranazh	

- Shtypni përkthimin(et).

Fjala anglisht:	ANG
gear	

- Shtypni përsëri ENTER.
- Zgjidhni një shkurtim të përshtatshëm të pjesës së ligjëratës duke kaluar lart e poshtë duke përdorur ↓, ↑. Shtypni ENTER.

Pjesë e ligjëratës
ART
ADV
N
V

Regjistrimi do të ruhet dhe ju do të ktheheni në listën e regjistrimeve.

GRAMATIKA

EAI400T përmban *Gramatikën e anglishtes për ata yre që nuk flasin anglisht*.

- ✓ *Gramatika* është e disponueshme vetëm në shqip.
- Hapni seksionin *Gramatika*.

Gramatika përmban tre menu hierarkike prej tre nivelesh. Ju mund të mbërrini tek niveli i tretë i menisë duke zgjedhur njëri pas tjetrit subjektet nga menuja.

LIBRI I FRAZAVE

Libri i frazave përmban mbi 1,100 fraza në anglisht dhe përkthimet e tyre, të ndara në 12 subjekte bisedimore:

Biseda e përditshme

Blerje

Transport

Në udhëtim	Udhëtim turistik	Shëndet
Në hotel	Mjete komunikimi	Kozmetika
Në restorant	Në bankë	Thërritja e policisë

Shumica e subjekteve përbajnë një numër prej disa nënsubjektesh.

- Hapni seksionin *Libri i frazave*.

Libri i frazave
Biseda e përditshme
Në udhëtim
Në hotel
Në restorant

- Zgjidhni një subjekt. Shtypni ENTER për të parë nënsubjektet e tij.

FOLJET E PARREGULLTA

Të gjitha foljet e parregullta të përdorura shpesh në anglisht janë vendosur në rendin alfabetin në seksionin *Foljet e parregullta*.

- Hapni seksionin *Foljet e parregullta*.
- Shtypni shkronjen e parë të foljes së dëshiruar dhe kaloni lart e poshtë në listë për t'a gjetur atë.

take; took; taken
marr, kap, nxjerr

IDIOMA TË NJOHURA

Mbi 200 idioma amerikane të përdorura gjërisht dhe të barasvlershme apo përkthimet e tyre përfshihen në seksionin *Idioma të njohura*.

- Hapni seksionin *Idioma të njohura*.
- Shtypni shkronjën e parë të idiomës së dëshiruar dhe kaloni lart e poshtë në listë për t'a gjetur atë.

take advantage of
shfrytëzoj

TELEFONA

Në këtë seksion ju mund të vendosni emra, numra telefoni dhe faksi, si dhe adresa postare dhe të e-mail në anglisht dhe shqip.

- Hapni seksionin *Telefona*. Ju do të shihni një listë të regjistrimeve telefonike ekzistuese të renditura sipas emrit.

Emri: Smith John Numri i telefonit 99999999 [3/3]
--

Krijimi i një regjistrimi

- Për të hapur një mostër të re regjistrimi, shtypni ENTER kur të jeni në listën e regjistrimeve. Nëse nuk ka asnjë regjistrim të vendosur, një mostër e re regjistrimi do të krijohet automatikisht kur të hapni listën.
- Filloni duke plotësuar faqen *Emri*.
- Për të hapur faqen tjetër, shtypni ENTER.
- ✓ Eshtë e nevojshme që të plotësohet faja *Emri* për të vazhduar në faqet e mëpasshme.

Gjetja e një regjistrimi

Ekzistojnë dy mënyra për të gjetur një regjistrim:

- Kur në listën e regjistrimeve ju mund të filloni të shtypni një emër të përfshirë në një regjistrim të vendosur.

Përdorni:

- BS për të fshirë fjalën e vendosur
- ⇔ për të kaluar mes anglishtes dhe shqipes

- Regjistrimet janë të renditura alfabetikisht sipas emrit. Ju mund të kaloni nëpër listën e regjistrimeve duke përdorur ▼ ose ▲ .

ORARI

Ju mund të administroni në mënyrë efektive kohën tuaj duke përdorur seksionin *Orari*.

- Hapni seksionin *Orari*. Lista e orarëve ekzistuese do të hapet. Regjistrimet janë të renditura sipas datës dhe kohës.

Data: 12/07/2002
Koha: 14:49 10 min.
Përmbajtja:
Meeting
[00]

Krijimi i një regjistrimi

- Për të hapur një mostër të re regjistrimi, shtypni ENTER kur të jeni në listën e regjistrimeve. Nëse nuk ka asnjë regjistrim të vendosur, një mostër e re regjistrimi do të krijohet automatikisht kur të hapni listën e regjistrimeve.

Data:
12/07/2002
Koha:
14:49
Kujtues 10 min.

Faqja e parë e një regjistrimi përfshin informacionin mbi *Datën*, *Kohën* dhe *Kujtuesin* e dëgjueshëm. Faqja e dytë - *Përmbajtja* - përfshin informacionin në lidhje me veprimtarinë.

Data dhe *Koha* përcaktojnë momentin e veprimit të *Programit të alarmit*.

Kujtuesi përcakton periudhën kohore derisa do të fillojë *Programi i alarmit*.

- Vendosni datën dhe kohën dhe përcaktoni periudhën kohore derisa do të fillojë *Programi i alarmit*.
- Shtypni ENTER për të hapur faqen *Përmbajtja*.
- Shtypni ENTER për të ruajtur një regjistrim.
- ✓ Kujtesa e *Orarit* është e kufizuar deri në 50 regjistrime. Mesazhi *Kujtesë e pamjaftueshme* shfaqet kur lista e regjistrimeve është plot.

Gjetja e një regjistrimi

Regjistrimet janë të renditura sipas datës dhe kohës. Përdorni ▼, ▲ për të kaluar nëpër listën e regjistrimeve.

Kujtuesi dhe Programi i alarmit

Nëse është aktivizuar, *Kujtuesi* tingëllon në kohën e përcaktuar deri sa të fillojë *Programi i alarmit*, duke krijuar një sinjal të dëgjueshëm. *Kujtuesi* është automatikisht i fikur për një regjistrim të ri. *Koha* e *Kujtuesit* rregullohet veçmas për çdo regjistrim individual.

- ✓ *Kujtuesi* dhe *Programi i alarmit* tingëllon edhe nëse pajisja është e mbyllur.
- ✓ Nëse një *Kujtues* dhe *Alarmi i përditshëm* kanë të njëjtën datë dhe kohë, do të shfaqet vetëm *Kujtuesi* meqëse ai ka një përparësi më të lartë.

Regjistrimi korrespondues *Orari* do të shfaqet në formën e shikueshme në këtë kohë.

- Shtypni ndonjë buton për të ndërprerë një sinjal të *Programit të alarmit* ose të një *Kujtuesi*.

Ju mund t'a ndryshoni regjistrimin dhe të vendosni *Kujtuesin* për një kohë të mëvonshme. Mbyllja e dritares të *Kujtuesit* të *Orarit* do t'ju çojë përsëri në seksionin (për shembull, *Fjalori*) ku ishit përpara sesa të fillonte alarmi.

KALKULATOR

- Hapni seksionin *Kalkulator*.

Kur futni numrat dhe veprimet nga tastiera, nuk është e nevojshme të shtypni butonin SHIFT ndërsa jeni në formën *Kalkulator*. Përdoreni këtë program si një kalkulator të zakonshëm xhepi.

SHKËMBIMI METRIK

Me EAI400T tuaj mund të shndërroni lehtësisht masat nga sistemi britaniko-amerikan në sistemin metrik të përdorur gjërësisht në Europë dhe anasjelltas, si dhe të shndërroni brenda secilit sistem.

- Hapni seksionin *Shkëmbimi metrik*.
- Zgjidhni një nënseksion duke shtypur ↓, ↑. Shtypni ENTER.
- Futni vlerën
- ✓ Mund të ketë më shumë se katër njësi masash në një nënseksion.

SHKËMBIMI I MONEDHËS

Funksioni *Shkëmbimi i Monedhës* ju lejon të llogaritni menjëherë vlerat e shkëmbimit ndërmjet nëntë monedhave të instaluara paraprakisht dhe tre monedha të përcaktuara nga përdoruesi.

- Hapni seksionin *Shkëmbimi i Monedhës*.
Vendosja dhe kontrollimi i kursit
- Zgjidhni nënseksionin *Vendosja e kursit* për të përcaktuar emrat dhe kurset e monedhës.
- Zgjidhni një monedhë. Shtypni ENTER.
- ✓ Ju mund të përcaktoni ose të ndryshoni emrat e çdo monedhe të renditur. Monedhat e reja mund të shtohen në vend të ???.
- Ndryshoni/përcaktoni emrin e monedhës. Shtypni ENTER për të hapur dritaren tjetër.
- Përcaktoni një kurs shkëmbimi në lidhje me monedhën kryesore (kursi i të cilës duhet të jetë i barabartë me 1).

✓ Kursi automatik i shkëmbimit për të gjitha monedhat është 1.

- Shtypni ENTER për të ruajtur ndryshimet.

Shkëmbimi

- Hapni nënseksionin *Llogaritja*.
- Zgjidhni emrin e një monedhe dhe vendosni një shumë.

Pas të keni shtypur një shumë të re në një prej rreshtave, do të kryehet shkëmbimi.

LOJA ME FJALË HANGMAN

EAI400T paraqet lojën mësimore *Hangman*, e cila mund t'ju ndihmojë të përmirësoni aftësitë tuaja të drejtshkrimit dhe të shtoni fjalorin tuaj personal.

- Hapni seksionin *Hangman*.
- Zgjidhni gjuhën e synuar duke shtypur ⇔. Pasi të jetë zgjedhur gjuha, do të fillojë një lojë e re.
- Përpiquni t'i gjeni shkronjat e fjalës duke i shtypur ato në tastierë. Nëse e gjeni një shkronjë saktësisht, ajo do të shfaqet në vendin e një asteriku në fjalë. Numri që paraqitet tregon numrin e mundësive të mbetura.
- Kur jeni duke luajtur, shtypni ENTER për të shfaqur përkthimin e fjalës së fshehur (e cila do të llogaritet si një herë). Për të fshehur përkthimin, shtypni ESC.
- Shtypni SAY për të dëgjuar fjalën e fshehur (llogaritet si një herë).
- Pas përfundimit të lojës, do të shfaqet fjala e fshehur dhe përkthimi(et) e saj.
- Shtypni ESC për t'u kthyer tek një lojë e re.

KOHA NË BOTË

Duke përdorur seksionin *Koha në botë*, ju mund të shihni kohën e tanishme në qytetet kudo në botë.

- Hapni seksionin *Koha në botë*.

<p>Koha në botë Tiranë Shqipëri Enj, 18 Korrik, 2002 20:31:41</p>
--

Ekрани *Koha në botë* tregon emrat e qytetit dhe vendit të zgjedhur (automatikisht: Tiranë, Shqipëri), datën, ditën e javës dhe kohën e tanishme për këtë qytet.

- Për të parë informacionin për një qytet tjetër, kaloni nëpër listën alfabetike duke përdorur ↓, ↑.
- Për të parë informacionin për një qytet tjetër të të njëjtit vend, kaloni nëpër listën alfabetike duke shtypur ▼, ▲.
- Gjithashtu, ju mund të gjeni shpejt një qytet të dëshiruar duke shtypur shkronjën e parë të emrit të tij dhe duke kaluar nëpër listë përmes përdorimit të ↓, ↑.
- Kur të gjeni qytetin e dëshiruar, shtypni ENTER për të ruajtur ndryshimet. Herën tjetër që të hapni këtë seksion qyteti që keni zgjedhur do të shfaqet i pari.

KOHA NË VEND


- Hapni seksionin *Koha në vend*.

Ekranin *Koha në vend* tregon emrin e qytetit dhe vendit të zgjedhur (automatikisht: Nju Jork, SHBA), datën, ditën e javës dhe kohën e tanishme për atë qytet. Ju mund t'i përcaktoni këto regjistrime në seksionin *Vendosja*.

LIDHJE ME KOMPJUTER

Duke përdorur kabllon e EAI400T për lidhje me kompjuter (i disponueshëm veçmas si pjesë e Paketës së Komunikimit) dhe programin kompjuterik për lidhje me kompjuter (i përfshirë në një CD-ROM në paketën standarte) mund të kaloni të dhëna nga EAI400T juaj dhe një kompjuter personal. Kjo karakteristikë do t'ju lejojë të mbani një kopje rezervë të të dhënave të *Telefonat*, *Orarit*, dhe *Fjalorit të përdoruesit* në kompjuterin tuaj.

Programi kompjuterik

- Futni CD e ofruar në pajisjen CD-ROM të një kompjuteri. Nëse programi i instalimit nuk fillon automatikisht, aktivizoni fishën INSTALL.exe nga lista fillestare në CD.
- Zgjidhni *Lidhje me kompjuter EAI400T* nga menuja që shfaqet në kompjuter.
- Pasi të instalohet programi, aktivizojeni atë nga Start/Programs/Ectaco. Shenja  do të shfaqet në System Tray.
- ✓ Versioni më i fundit i programit kompjuterik Dalja për lidhje me kompjuter dhe fjalorë shtesë mund të merren nga faqja ne Web e Ectaco në www.ectaco.com

Dërgimi dhe marrje

- Bashkoni kabllon e lidhjes me kompjuterin me folen e *Lidhjes me kompjuterin* që gjendet në anën e djathtë të pajisjes.
- Hapni seksionin *Lidhje me kompjuter*.
- Klikni me të djathtën në shenjëën e Lidhjes me kompjuter në System Tray. Në programin *Lidhje me kompjuter*, zgjidhni formën e përshtatshme të transferimit të të dhënave.
- ✓ Sigurohuni që të zgjidhni një fole të përshtatshme COM.
- ✓ Sigurohuni që të mos keni asnjë program tjetër të *Lidhjes me kompjuter* të aktivizuar në të njëjtën kohë me *Lidhjen me kompjuter EAI400T*.
- Zgjidhni formën e transferimit *Dërgimi i të dhënave*. Shtypni ENTER.
- Zgjidhni seksionin(et) që dëshironi të dërgoni. Përdorni SPACE për të konfirmuar ose jo një seksion.

Dërgimi i dhënave	
<input checked="" type="checkbox"/>	Telefona
<input checked="" type="checkbox"/>	Orari
<input checked="" type="checkbox"/>	Fjalori anglisht i përdor...
<input checked="" type="checkbox"/>	Fjalori shqip i përdorue...

- Shtypni ENTER për të filluar transferimin.
- ✓ Filloni transferimin e të dhënave që pari në pajisjen marrëse, pastaj në pajisjen dërguese.
- Për të marrë të dhënat, zgjidhni formën e transferimit *Marrja e të dhënave*. Shtypni ENTER dhe transferimi do të fillojë.
- ✓ Periudha kohore ndërmjet fillimit të transferimit të të dhënave në kompjuter dhe në pajisje nuk duhet të kapërcejë mbi 30 sekonda.
- ✓ Vini re se në formën *Marrja e të dhënave*, të dhënat më të reja të transferuara do të zëvendësojnë të gjithë informacionin e vjetër të ruajtur në seksionet korresponduese të pajisjes tuaj.
- ✓ Gjithnjë bëni një kopje rezervë të të gjitha të dhënave tuaja të rëndësishme! As prodhuesi dhe as shitësit nuk marrin përsipër ndonjë përgjegjësi për të dhënat e humbura ose të dëmtuara.
- ✓ Transferimi i të dhënave konsumon një sasi të konsiderueshme energjie. Këshillohet fuqishëm përdorimi i një furnizimi me energji nga jashtë.

VENDOSJA

Personalizoni EAI400T tuaj dhe siguroni mirëmbajtjen e regjistrimeve tuaja personale duke zgjedhur variantet në seksionin *Vendosja*.

- Hapni seksionin *Vendosja*.

Pjesa më e madhe e varianteve të seksionit *Vendosja* janë shumë të thjeshtë për t'u rregulluar. Nëse nuk është shprehur ndryshe, hapni një nënseksion dhe zgjidhni variantin e dëshiruar me ↓, ↑. Pastaj shtypni ENTER për të konfirmuar zgjedhjen tuaj.

Paraqitja gjuhësore

Gjuha e paraqitjes automatike e EAI400T është anglisht.

Blokimi i zhargonit

Në këtë nënseksion ju mund të fshihni fjalët ose frazat e zhargonit që përmbajnë fjalorët. Për shembull, ju mund të pengoni që fëmijët tuaj të kenë mundësinë e disponimit të zhargonit.

Për të fikur bllokimin e zhargonit, vendosni fjalëkalimin *showslan* dhe shtypni ENTER.

Kërkimi i përparuar

Ju mund të përshpejtoni punën e *Fjalorit* tuaj duke zgjedhur të fikni formën *Kërkimi i përparuar*. Automatikisht, *Kërkimi i përparuar* është i ndezur.

Sinjali i butonit

Kjo karakteristikë synon të krijojë një sinjal të shkurtër sa herë që shtypni një buton në tastierën e pajisjes. Sinjali i butonit është i aktivizuar automatikisht nga sistemi.

Ora

Në këtë nënseksion ju mund të zgjidhni qytetin që t'a shfaqni në seksionin *Koha* në vend dhe mund të rregulloni kohën e tanishme.

- ✓ Vlerat automatike janë 1 janar, 2002, 00:00 (12:00 e natës) dhe Nju Jork, SHBA
- Hapni nënseksionin *Ora e kohës së tanishme*.

<p>Vendos kohën në vend</p> <p>DD/MM/VV = <input type="text" value="12"/> / 07 / 2002</p> <p>13: 58</p>
--

- Përcaktoni datën dhe kohën e tanishme.
- Shtypni ENTER për të ruajtur ndryshimet. Seksioni tjetër që shfaqet do t'ju lejojë të zgjidhni qytetin vendor.

Nju-Jork SHBA -05:00 (GMT)

Ky ekran tregon emrin e qytetit dhe të vendit dhe ndryshimi i GMT-së së qytetit. Referojuni Faqes 40 për të mësuar sesi të gjeni vendin ose qytetin e dëshiruar në listë.

- Kur të gjeni qytetin e dëshiruar, shtypni ENTER për të ruajtur ndryshimet.

Vendosja e datës

Vendosja automatike e datës dita-muaji-viti mund të ndryshohet në muaji-dita-viti.

Vendosja e kohës

Vendosja automatike e kohës 24-orëshe (ushtarake) mund të ndryshohet në vendosjen amerikane 12-orëshe.

Programi i alarmit

Në këtë nënseksion ju mund të ndizni ose të fikni *Programin e alarmit*. Nëse është ndezur, gjë që është vendosja automatike, *Programi i alarmit do të aktivizohet në datën dhe kohën e regjistrimit të Orarit*, duke krijuar një sinjal të dëgjueshëm.

Alarm i përditshëm

- Hapni nënseksionin *Alarm i përditshëm*.
- ✓ Vlerat automatike janë mesnatë, 00:00, dhe i fikur.

Përdorni ▼, ▲ për të ndezur dhe fikur alarmin

- Shtypni ENTER për të ruajtur ndryshimet.
- Nëse është ndezur, *Alarm i përditshëm* krijon një sinjal në kohën e caktuar.
- Shtypni ndonjë buton për të ndërprerë sinjalin e *Alarmit të përditshëm* (përndryshe, sinjali do të vazhdojë për 30 sekonda).

Kontroll i kujtesës

Kontrolloni në çast gjendjen e kujtesës së lirë me këtë variant të *Vendosjes*.

- Hapni nënseksionin *Kontrolli i kujtesës* për të kontrolluar kujtesën e lirë të mbetur.

Fshirje e të dhënave

Nënseksioni *Fshirje e të dhënave* ju jep mundësinë që të çlironi burimet e kujtesës duke fshirë regjistrimet shumë më shpejt sesa t'i hiqni një nga një.

Vendosja e fjalëkalimit

Pa vendosur asnjë fjalëkalim (automatiki) të gjitha funksionet e EAI400T janë lirish të disponueshme. Pas vendosjes së një fjalëkalimi, seksionet e mëposhtme mund të bllokohen ndaj mundësisë së disponimit të paautorizuar:

<i>Telefona</i>	<i>Fjalorët e përdoruesit</i>	<i>Vendosja e fjalëkalimit</i>
<i>Orari</i>	<i>Fshirje e të dhënave</i>	<i>Mënyra e mbrojtjes</i>
<i>Komunikimi me kompjuter</i>		

Për të patur mundësinë e disponimit të ndonjë prej këtyre seksioneve në formën e bllokuar, duhet të vendoset një fjalëkalim i vlefshëm.

- Hapni nëseksionin *Vendosja e fjalëkalimit*.

Shtyp fjalëkalimin

[|]

- Përcaktoni një fjalëkalim deri në 8 shkronja të gjatë. Shtypni ENTER.
- Rishtypni fjalëkalimin për konfirmim. Shtypni ENTER.
- ✓ Gjithnjë mbani mend fjalëkalimin tuaj. Nëse e harroni, do t'u duhet të riaktivizoni sistemin, gjë që do të shkaktojë humbje të pakthyeshme të të dhënave të përdoruesit.

Ndryshimi i fjalëkalimit

- Hapni *Vendosja e fjalëkalimit*. Futni fjalëkalimin e tanishëm. Shtypni ENTER.
- Përcaktoni një fjalëkalim të ri. Shtypni ENTER.
- Rishtypni fjalëkalimin për konfirmim. Shtypni ENTER për të ruajtur fjalëkalimin.


Heqja e fjalëkalimit

- Hapni nëseksionin *Vendosja e fjalëkalimit*. Futni fjalëkalimin e tanishëm. Shtypni ENTER.
- Mos futni asnjë shkronjë në dy rreshtat e tjerë, thjesht shtypni dy herë ENTER.

Mënyra e mbrojtjes

Me ndihmën e nëseksionit *Mënyra e mbrojtjes* ju mund të mbron regjistrimet tuaja personale dhe të bllokoni funksionin *Komunikimi me kompjuter*.

- Hapni nëseksionin *Mënyra e mbrojtjes*. Shtypni ENTER.

Kur të zgjidhet varianti ndezur, bllokohet mundësia e disponimit të të dhënave dhe në vijën treguese shfaqet shenja .

- ✓ Rekomandohet që të mbyllet një seksion i mbrojtur nga fjalëkalimi përpara se të fikni pajisjen.

Mënyra e mbrojtjes mund të anulohet nëpërmjet vendosjes së një fjalëkalimi të vlefshëm kur ju kërkohet në rastin kur:

- është zgjedhur varianti i fikur në nënseksionin *Mënyra e mbrojtjes*
- është hapur ndonjë seksion i mbrojtur



Nivelimi i kontrastit

Nivelimi automatik i kontrastit mund të ndryshohet në nënseksionin *Nivelimi kontrastit*.

- Ndryshoni nivelin e kontrastit duke përdorur , .

Variantet e të folurit

Përshtateni siç dëshironi të folurin duke rregulluar shpejtësinë dhe frekuencën e sintetizatorit të të folurit të përfshirë në pajisje.

Përdorni ENTER për të kaluar ndërmjet rreshtave *Frekuenca e të folurit* dhe *Shpejtësia e të folurit* dhe ,  për të rregulluar nivelet e secilit variant.

Vë kohën e fikjes

Fikja automatike ka një pritje të paracaktuar prej 3 minutash. Kjo karakteristikë kursen kohëzgjatjen e baterisë duke e fikur pajisjen pas një periudhe të përcaktuar mospërdorimi. Fusha e rregullimit është nga 1 në 15 minuta.